



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13, 17, paragrafi 17.1, **pika j** të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, në harmoni me nenin 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës, në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore nxjerr këtë:

## V E N D I M

Për emërimin zo.Valentina Mehmeti Drejtoresh në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale

### Neni 1.

Drejtoresha në Drejtorinë për Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale Valentina Mehmeti në kuader të fushë-veprimtarisë së saj është përgjegjëse dhe obligohet për hartimin e strategjisë zhvillimore për kujdesin primar shëndetësor duke përfshirë promovimin, parandalimin, trajtimin, rehabilitimin e të sëmurve në territorin e Komunës së Vitisë

### Neni 2.

Bënë sigurimin dhe ofrimin e të gjitha shërbimeve shëndetësore të nivelit primar për të gjithë qytetarët pa kurrfarë diskriminimi

### Neni 3.

Bënë grumbullimin, përcjelljen dhe hartimin e politikave shëndetsore dhe politikave sociale afatshkurta, afat mesme dhe afatgjata duke ofruar zgjidhje dhe alternativa shëndetsore.

### Neni 4.

Udhëheq me përgjegjësi të lartë ligjore rregullativën ligjore në kuader të drejtorisë të cilën e drejton

### Neni 5.

Merr masa për të siguruar dhe identifikuar natyrën në permasat e nevojës për shërbimesociale dhe të gjithëmbarshme familjare, Brenda territorit të komunes së Vitisë.

Neni 6.

Kryen edhe punë të tjera të cilat i jepen nga eprori.

Neni 7.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 8.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryetarit të Komunës.

Vendimi i dorzohet:  
1.Zyres së Kryetarit  
2.Drejtoreshes  
3.Arkivit

Kryetari i Komunës  
/ Sokol Haliti

